

## **Kërkesë e Këshillit familjar dhe Grupit punues të Projektit „Ladorisht 2009“**

*Ladorishti në mbrojtje të vlerave historike dhe kombëtare*

### **I nderuari Kryetar i Komunës së Strugës Zoti Ramiz Merko**

Që nga krijimi i Këshillit nismëtar dhe angazhimi i tij i palodhshëm për realizimin e Projektit «**Ladorisht 2009**» e deri te radhitja e mëvonshme e shumë aktivistëve të flaktë për të punuar në Projekt. Këshilli nismëtar unanimisht vendosi krijimin e Grupit Punues si domosdoshmëri e kohës dhe punës efikase që duhej bër në Projekt.

Qëllimi kryesor i **Grupit punues** ishte krijimi i **Këshillit Familjar** si dhe informimin e plotë të ç`do familje apo të afërmit e tyre me punën dhe qëllimin e Grupit punues, ku shtylla kryesore e këtij Projekti do të ishin vetë familjarët.

Konsultimet dhe takimet me familjarët vazhduan rregullisht dhe shumica e tyre përkrahën Projektin, që në thelb ka meremetimin dhe ngritjen e një Lapidari madhështor dhe ruajtjen e vlerave historike e kombëtare për martirët, që deri më sot ju ka munguar, mbasi përmendorja e ndërtuar në vitin 1952 nuk është më e kohës dhe gjendja e varrezave është tepër e mjerushme ku rreziku që i kanoset Tempullit tonë të shejntë nga zhdukja është një fakt i hidhët por i vërtetë për Ladorishtin.

Bindshmëria e plotë në sukses e Grupit punues dhe të gjitha takimet e deritanishme me familjarët krijojnë një pasqyrë tjetër punuese dhe pikërisht më datën **31. Maj 2009 në Schwerzenbach të Zürich-ut** përfundimisht u krijua Këshilli familjar.

**Përkrahja e këtij Projekti ka rëndësi të madhe historike e kombëtare për Ladorishtin .** Me ngritjen e Lapidarit të ri dhe meremetimin e varrezave, Ladorishti **SOT** e përgjithmonë i thonë **STOP** harresës ndaj historisë sonë shekullore.

*Nëse një Popull nuk e njeh të kaluarën e Tij, nuk mund ta ndërtojë të ardhmen e vet*

I nderuari Zoti Kryetar Ramiz Merko, nga të gjitha konsultimet e deritanishme të Këshillit familjar dhe Grupit të tij punues përfundimisht u vendos që për plotësimin e dokumentacionit dhe mbarëvajtjes së Projektit për meremetimin e Varrezave kemi nevojë për sqarime zyrtare nga Institucionet komunale të Strugës që puna e Projektit të përfundojë pa asnjë pengesë.

Bashkëpunimi jonë me Bashkësinë Lokale dhe asociacionet e saj si : Këshilli i xhamisë në fshat, Shoqëria kulturore artistike etj, është në funksion të plotë, ku njëkohësisht posedojmë edhe autorizimet e tyre.

Sqarimet që kërkohen për plotësimin përfundimtar të Projektit nga Ju dhe Institucionet e Komunës së Strugës janë :

- a) Sqarimin e çështjes së pronës ku ndodhen varrezat (janë pronë shtetërore apo të fshatit)
- b) Sqarimin e marrjes së lejes zyrtare për ndërtim (duhet apo jo)
- c) Sqarim mbi mbrojtjen e Lapidarit nga LNC e veteranëve të luftës (a ka nevojë për leje speciale).

Shpresojmë se për sqarimet e mësipërme nga ana juaj do të jenë pozitive dhe produktive që Projekti të fillojë plotësisht i kompletuar dhe pa pengesa institucionale nga ana e Komunës së Strugës.

Për informata të mëtutjeshme në lidhje me Projektin dhe sqarimet zyrtare që duhet realizuar si Kryetar Komune dhe Institucionet e saj, mund të kontaktoni në ç`do kohë me Grupin punues në këtë faqe të Internetit [www.pro-ladorisht.org](http://www.pro-ladorisht.org).

***Lavdi dëshmorëve të kombit***

Me nderime dhe respekt Ju përshëndet Këshilli familjar dhe Grupi i tij punues  
Për informata të mëtutjeshme mundë të shkruani në [info@pro-ladorisht.org](mailto:info@pro-ladorisht.org)

## Vërtetim pranimi

Me këtë vërtetim dëshmohet pranimi i kërkesës që është dorëzuar Kryetarit të Komunës së Strugës Zotit Ramiz Merko nga ana e Grupit punues të Projektit „Ladorisht 2009“ në Zürich të Zvicrës më datën: 13. Qershor 2009

Nënshkrimet vijojnë: **Kryetari i Komunës së Strugës Zoti Ramiz Merko**

*Ramiz Merko*



Grupi Punues i Projektit „Ladorisht“ 2009

Rini Dauti .....

Jeton Lleshi .....

Idriz Murtishi .....

Shkëndi Lena .....

Azir Ajro .....

Vendi: *Dübendorf*

Data: 13. Qershor 2009